
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS

DOKUMENTET E PROCEDURËS SË
TENDERIT
PËR
KONCESIONIN E AUTOSTRADËS
MILOT - MORINË
KËRKESË PËR PROPOZIM



29 Prill 2016

Përbajtja

TOC

Përkufizime

Termet e përkufizuara në Draft-Kontratën e Koncesionit në Shtojcën 8 do të kenë, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në Dokumentet e Procedurës së Tenderit, të njëjtët kuptime si në rastet kur përdoren në Dokumentet e Procedurës së Tenderit.

“Ofertë” do të thotë një Ofertë e dorëzuar në përputhje me këta Dokumente të Procedurës së Tenderit.

“Dokumentet e Ofertës” do të thotë dokumentet e dorëzuar nga një Ofertues i Mundshëm si pjesë e një Oferte në përputhje me paragrafin 16.

“Komiteti i Vlerësimit të Ofertave” do të thotë komiteti i vlerësimit të ofertave të ngritur nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE", i ndryshuar.

“Kërkesat e Ofertës” do të thotë kërkesat e ofertës të përcaktuara në paragrafin 16.

“Garancia e Ofertës” do të thotë çdo sigurim oferte që kërkohet në përputhje me VKM Nr. 634, datë 1/10/2014.

“Procedurë Konkurruese” do të thotë procedura konkurruese e përcaktuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.

“Dokumentet e Procedurës Konkurruese” do të thotë ky dokument i procedurës konkurruese së bashku me Shtojcat 1 – 14.

“Mbyllja Financiare e Punimeve Kapitale” do të thotë data në të cilën Koncesionari arrin mbylljen financiare në lidhje me Punimet Kapitale.

“Kontratë Koncesioni” do të thotë draft-kontrata e koncesionit e bashkëngjitur në Shtojcën 8.

“Personi i Kontaktit” do të thotë personi i identifikuar në paragrafin 2.1.3.

“Sigurimi i Kontratës” do të thotë çdo sigurim kontrate i kërkuar në përputhje me paragrafin 2.1.5.

“Autoriteti Kontraktues” do të thotë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë.

"Manualet e Çmimeve për Njësi të Ndërtimit" do të thotë paketa e çmimeve të referencës së tregut miratuar nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe publikuar çdo gjashtë muaj në Gazetën Zyrtare dhe në www.transporti.gov.al ose në rast se publikimi ndërpritet, çdo manual tjetër që mund të zëvendësojë formën aktuale kohë pas kohe apo që miratohet mes Palëve që veprojnë në mënyrë të arsyeshme për të qenë një zëvendësim i pranueshëm.

“Qendrat e të Dhënave” do të thotë Qendra Virtuale e të Dhënave dhe disqet me të dhëna që vihen në dispozicion të Ofertuesve të Mundshëm.

“VKM Nr.634, datë 1/10/2014 do të thotë Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR

NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE", i ndryshuar.

"Memorandumi i Due Diligence" do të thotë marrëveshja e lidhur nga secili prej Ofertuesve të Mundshëm në lidhje me proceset dhe rregullat e Qendrave të të Dhënave.

"Ofertë Financiare" do të thotë dokumentet që përfshijnë seksionin financiar të Ofertës siç përcaktohet në paragrafin 16.4.

"Autostradë" do të thotë Autostrada Milot – Morinë siç përshkruhet në Kontratën e Koncesionit.

"Anëtari Drejtues" do të jetë anëtari i një konsorciumi i autorizuar siç kërkohet nga të gjithë anëtarët e tjerë të konsorciumit për të vepruar në emër të tyre në lidhje me Projektin.

"Ofertë Ligjore" do të thotë dokumentet që përfshijnë seksionin ligjor të Ofertës siç përcaktohet në paragrafin 16.2.

"Aplikim Parakualifikimi" ka kuptimin e dhënë në Kërkesën për Parakualifikim.

"Ofertues i Parakualifikuar" ka kuptimin e dhënë në Kërkesën për Parakualifikim.

"Ofertues i Mundshëm" ka kuptimin e dhënë në Kërkesën për Parakualifikim.

"Modeli Financiar Referencë" do të thotë modeli financiar i audituar i Ofertuesit të Përzgjedhur siç rishikohet dhe miratohet nga Autoriteti Kontraktues.

"Kërkesë për Kualifikim" do të thotë kërkesa për kualifikim në lidhje me Projektin e njoftuar në datën ose rreth datës së Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

"Ofertuesi i Përzgjedhur" do të thotë Ofertuesi i Mundshëm i përzgjedhur për të lidhur Kontratën e Koncesionit si një rezultat i arritjes së pikëzimit më të mirë në vlerësimin e Ofertave.

"Njoftimi i Shpalljes së Ofertuesit të Përzgjedhur" do të thotë një njoftim në formën e Shtojcës 4.

"Afati i Dorëzimit" do të thotë ora dhe data e afatit të dorëzimit të përcaktuar në paragrafin 2.2.1.

"Ofertë Teknike" do të thotë dokumentet që përfshijnë seksionin teknik të Ofertës siç përcaktohet në paragrafin 16.3.

"Qendra Virtuale e të Dhënave" do të thotë dhoma e të dhënave (data room) virtuale e due diligence (e aksesueshme përmes Internetit).

Dokumentet e Procedurës Konkurruese

1. Informacion i Përgjithshëm

1.1 Objektivi i Procedurës Konkurruese

Autoriteti Kontraktues ka vendosur të japë një koncesion për të përmirësuar, shfrytëzuar dhe mirëmbajtur Autostradën Milot – Morinë (Projekti) përmes një partneriteti publik privat, në përputhje me termat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

1.2 Ofertuesit e Mundshëm

Të gjithë palët e interesuara janë të ftuar të dorëzojnë Dokumentet e Ofertës për Projektin.

1.3 Përshkrimi i Autostradës

Autostrada përbën pjesë të rrjetit të Rrugëve Kombëtare të Shqipërisë. Duke lidhur Milotin, rreth 60 km në verilindje të portit të Durrësit në detin Adriatik, me Morinën në kufi me Kosovën, rruga formon seksionin qendror të Autostradës më të gjerë Shqipëri Kosovë, duke lidhur Tiranën dhe Durrësin me Kosovën.

E ndërtuar në faza, Autostrada përbëhet nga tre seksione, të ndërtuara me standarde të ndryshme inxhinierike:

- Seksioni 1: Milot - Rrëshen (26 km) është një rrugë me dy korsi e financuar nga Banka Botërore, IDA dhe Fondi i OPEC-ut. Seksioni fillon në Kryqëzimin e Milotit, i cili është në prerjen me autostradën Tiranë-Shkodër;
- Seksioni 2: Rrëshen - Kalimash (60,3 km) është një autostradë me katër korsi në terren malor, e ndërtuar nga Bechtel-Enka JV ndërmjet Prillit 2007 dhe Qershorit 2009 me financim nga Qeveria. Ai përfshin tunelin Thirrës prej 5.5 km ;
- Seksioni 3: Kalimash - Morinë (28,2 km) është një rrugë me katër korsi me përjashtim të shtatë urave të cilat janë me dy korsi, të përfunduar në vitin 2011 me financim të Qeverisë.

Autostrada përmban 57 ura dhe 5 mbikalime. Nga 57 ura, 37 janë me karrexhatë të dyfishtë (të gjitha urat në Seksionin 2 dhe disa në Seksionin 3), 16 janë me një karrexhatë (të gjitha urat në Seksionin 1 dhe ura ekzistuese mbi lumin Drin) dhe pjesa tjetër janë në ndërtim nga Qeveria (karrexhata e majtë, të gjitha në Seksionin 3).

Fortësia e shtrojës së rrugës është e kënaqshme dhe nuk pritet të ndodhin prishje për shkak të trafikut. Seksioni 2 është ndërtuar me një shtrojë gjysmë të ngurtë, ndërkohë që Seksionet 1 dhe 3 kanë një strukturë të përkulshme të shtrojës.

Trafiku përgjatë Autostradës ndryshon ndërmjet 4,200 AADT në tunelin e thirrës (Seksioni 2) dhe 6,400 AADT në afërsi të Milotit (Seksioni 1).

1.4 Përmbledhja e kushteve kryesore të Koncesionit

Objektivi kryesor i Koncesionit është përmirësimi i Autostradës, veçanërisht punimet e stabilizimit të shpateve, dhe operimin dhe mirëmbajtjen e tij efektive. Kushtet thelbësore të Koncesionit përfshijnë të mëposhtmet:

1. Objekti i koncesionit/projektit PPP: rruga ndërmjet Milotit dhe Morinës, që përbëhet nga seksionet Milot-Rrëshen, Rrëshen-Kalimash, dhe Kalimash-Morinë.
2. Kohëzgjatja e koncesionit: 30 vjet (në varësi të ndërprerjes më të hershme të Kontratës së Koncesionit në përputhje me kushtet e saj).
3. Aktivitetet për tu kryer nga koncesionari: përmirësimi, financimi, ndërtimi, shfrytëzimi (përfshirë mbledhjen e pagesës) dhe mirëmbajtja e autostradës Milot-Morinë në varësi të standardeve të performancës të përcaktuara në kontratë.
4. Burimet e të ardhurave të Koncesionarit: (i) të ardhurat nga tarifa të grumbulluara nga përdoruesit e rrugës; (ii) një subvencion vjetor i pagueshëm nga Autoriteti Kontraktues për Koncesionarin, niveli i të cilit do të përcaktohet (dhe nënshtrohet një mekanizmi indeksimi i definuar në Kontratën e Koncesionit) dhe propozohet nga Koncesionari si pjesë e Ofertës së tij; dhe (iii) pagesat e marra nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me të Ardhurat e Garantuara të Trafikut siç përcaktohen në Kontratën e Koncesionit. Për shmangien e dyshimit pagesat sipas pikës (iii) më sipër do të bëhen në rast se të ardhurat nga tarifa e grumbulluar sipas pikës (i) bien poshtë nivelit të të Ardhurave të Garantuara të Trafikut dhe do të bëhen vetëm për të adresuar mungesën.
5. Pagesa e koncesionit e pagueshme nga koncesionari: nuk ka.
6. Legjislacioni i zbatueshëm: Kontrata e Koncesionit do të rregullohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.
7. Kriteri i tenderit: ofertuesi fitues do të përzgjidhet në bazë të subvencionit vjetor më të ulët të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

2. Njoftim Kontrate

2.1 E përgjithshme

2.1.1 Autoriteti Kontraktues

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë.

2.1.2 Adresa e Autoritetit Kontraktues

Sheshi "Skenderbej", No. 5
Tirana, Albania

2.1.3 Emri dhe adresa e personit të kontaktit

Mr. Eduart Seitaj
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej", Nr. 5
Tirana, Albania
Email: Eduart.Seitaj@transporti.gov.al

Çdo komunikim, pyetje, sqarim ose informacion që kërkohet nga Ofertuesit e Mundshëm rreth Procedurës së Tenderit duhet t'i adresohet vetëm Personit të Kontaktit, me një kopje për Drejtuesin e Transaksionit të IFC-së në okudashov@ifc.org

2.1.4 Lloji i Autoritetit Kontraktues dhe fusha e veprimi apo aktiviteti kryesor i tij

Institucion Qendror

2.1.5 Nënshkrimi i kontratës

Autoriteti Kontraktues do të informojë Ofertuesin e Përzgjedhur duke nxjerrë një Njoftim të Shpalljes së Fituesit. Një kopje e hollësishme e këtij njoftimi do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Autoriteti Kontraktues do të kërkojë Sigurim Kontrate për performancën e Kontratës së Koncesionit në përputhje me kushtet e Kontratës së Koncesionit.

2.1.6 Ligji Rregullues

Të gjithë dokumentet e ofruar nga Autoriteti Kontraktues për Ofertuesit e Mundshëm rregullohen dhe interpretohen në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

2.2 Procedura Konkurruese

2.2.1 Oferta

Afati i Dorëzimit të Ofertave është:

Data: 30 Maj, 2016

Ora: 3:00.MD Ora e Evropës Qendrore

Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë Dokumentet e Ofertës së tyre në anglisht ose shqip, në format elektronik, duke i ngarkuar ato përpara Afatit të Dorëzimit në portalin në internet të Agjencisë së Prokurimeve Publike të Shqipërisë në www.app.gov.al. Ofertat e dorëzuara pas Afatit të Dorëzimit do të refuzohen.

Udhëzimet për ngarkimin e Dokumenteve të Ofertës mund të gjenden në gjuhët shqipe dhe angleze në portalin në internet të Agjencisë së Prokurimeve Publike të Shqipërisë në www.app.gov.al. Kërkesat për qartësim në lidhje me dorëzimin elektronik të Dokumenteve të Ofertës do t'i dorëzohen Personit të Kontaktit në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 2.1.3 të kësaj Kërkese për Propozime.

Secila faqe e dokumenteve që përmbahen në Ofertën origjinale duhet të jenë të numëruara sipas radhës dhe të sigluara.

Të gjitha shifrat e shprehura në Ofertë duhet të jenë të shprehura në formatin e mëposhtëm "1,000 (një mijë)" dhe në rast të mospërputhjes fjalët do të kenë përparësinë ndaj numrave.

2.2.2 Qendra Virtuale e të Dhënave

Një Ofertues i Mundshëm duhet të aplikojë për akses në Qendrën Virtuale të të Dhënave duke i dërguar një email Personit të Kontaktit, me një kopje për IFC, sipas paragrafit 2.1.3. Pas marrjes së email-it Autoriteti Kontraktues ose IFC në emër të tij, do t'i dërgojë Ofertuesit të Mundshëm një kopje të Memorandumit të Due Diligence dhe Marrëveshjes së Konfidencialitetit, të cilat Ofertuesi i Mundshëm dihet t'i nënshkruajë dhe t'ia kthejë menjëherë Personit të Kontaktit, me një kopje për IFC, sipas paragrafit 2.1.3, pas së cilës Ofertuesi i Mundshëm do të marrë një ftesë për akses në Qendrën Virtuale të të Dhënave.

2.2.3 Pyetjet

Kërkesat për sqarim rreth Dokumenteve të Procedurës Konkurruese duhet të dorëzohen përmes e-mail tek personat e kontaktit të renditur në paragrafin 2.1.3.

Kërkesat për sqarim mund të dorëzohen çdo moment përpara:

Datës 16 Maj 2016 Ora: 3:00.MD Ora e Evropës Qendrore

Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë i detyruar t'i përgjigjet asnjë kërkesë për sqarim apo ndonjë komunikimi tjetër pas kësaj date.

Autoriteti Kontraktues do të shpërndajë përgjigjet ndaj kërkesave për sqarim përmes Qendrës Virtuale të të Dhënave tek të gjithë Ofertuesit e Mundshëm pa përjashtim.

2.2.4 Të Dhënat dhe Informacioni mbi Projektin

Autoriteti Kontraktues ka përfunduar analizat e mëposhtme, raportet e të cilave janë vënë në dispozicion për Ofertuesit e Mundshëm në Faqen Virtuale të të Dhënave:

- analizat e trafikut dhe studimi i fizibilitetit të pagesës, të cilat përfshijnë informacion rreth numërimit të trafikut, intervistat me përdoruesit e rrugës, anketimet e gatishmërisë për të paguar, intervista me kompanitë e transportit dhe parashikimet e trafikut dhe të ardhurave;
- diagnozë gjithëpërfshirëse e kushteve të Autostradës, përfshirë vlerësimin e cilësisë së shtrojës së rrugës, testimi i stresit të urave, etj.;
- studimi gjeoteknik, i cili përfshiu një rilevim LiDAR të të gjithë seksioneve komplekse gjeologjike të Autostradës, imazheria në ortofoto, testim i detajuar i terrenit, harta gjeologjike inxhinierike me shkallë 1:1.000 si dhe identifikimi, përcaktimi, përshkrimi dhe klasifikimi i rrezikut për të gjitha shpatet në Autostradë;
- vizatimet siç është ndërtuar të urës ekzistuese të Drinit dhe projekti konceptual i urës së re mbi Drin.

2.2.5 Proceset dhe Rregullat e Qendrave të të Dhënave

Ofertuesit e Mundshëm lejohen të hyjnë në Qendrat e të Dhënave vetëm në përputhje me proceset dhe rregullat e përcaktuara në Memorandumin e Due Diligence.

2.2.6 TVSH

Përveç rasteve të deklaruar ndryshe, të gjitha referencat e kostove, shpenzimeve, tarifave dhe çmimeve do të shprehen pa TVSH.

3. Konfidencialiteti

3.1 Konfidencialiteti i Ofertës

Çdo material, dokument, akt apo deklaratë e shkruar që përmban ndonjë informacion do të konsiderohet konfidencial nëse ai:

- është sekret për vetë natyrën e tij;
- përcaktohet që është konfidencial.

Ofertuesit e Mundshëm duhet të identifikojnë qartësisht çdo dokument apo informacion që ata dëshirojnë të mbetet konfidencial duke plotësuar formularin siç jepet në Shtojcën 12 “Lista Informacionit Konfidencial”.

Çdo diskutim, komunikim apo negociim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesit të Mundshëm mbetet konfidencial. Nëse nuk kërkohet nga ligji, vendimi i gjykatës apo kërkesa për propozim, asnjë palë nuk mund të publikojë informacion teknik, informacion mbi çmimet apo ndonjë informacion tjetër të lidhur me Procedurën Konkurruese pa miratim paraprak.

Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë shkelur detyrimet për të ruajtur konfidencialitetin në lidhje me një Ofertues të Mundshëm në rastet kur të dhënat:

- u janë dhënë nga Autoriteti Kontraktues punonjësve, këshilltarëve apo nënkontraktorëve e tij vetëm në lidhje me Procedurën Konkurruese apo me qëllim përgatitjen apo menaxhimin e ndonjë kontrate.
- u janë dhënë personelit të Autoritetit Kontraktues për të mundësuar menaxhimin dhe kontrollin efektiv të Procedurës Konkurruese;
- janë nxjerrë nga Komiteti i Vlerësimit të Ofertave për të mundësuar vlerësimin e Ofertave;
- janë nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues si përgjigje ndaj një kërkesë të një komisioni të Kuvendit të Shqipërisë;
- janë nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues brenda Qeverisë së Shqipërisë ose për një Drejtori ose Agjenci Qeveritare në përputhje me interesat legjitime të Qeverisë së Shqipërisë dhe Autoritetit Kontraktues;
- kërkohen që të shpallen nga ligji.

3.2 Konfidencialiteti i informacionit të Autoritetit Kontraktues

Informacioni i ofruar nga Autoriteti Kontraktues për Ofertuesit e Mundshëm do të trajtohet si konfidencial nga Ofertuesi i Mundshëm, përfaqësuesit dhe konsulentët e tij.

Ofertuesit duhet të garantojnë që punëdhënësit, nënkontraktorët dhe konsulentët e tyre nuk do të publikojnë apo komunikojnë të dhëna të marra gjatë përgatitjes së Ofertës nga Autoriteti Kontraktues, Komiteti i Vlerësimit të Ofertave apo ndonjë palë e tretë përveç se kur lejohet nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që i gjithë informacioni i shkruar (qoftë konfidencial ose jo dhe pavarësisht mënyrës se si ky informacion u është dhënë Ofertuesve të Mundshëm) i dhënë Ofertuesve të Mundshëm:

- t'i kthehet Autoritetit Kontraktues - rast në të cilin i gjithë ky informacion do të kthehet menjëherë nga Ofertuesi i Mundshëm në adresën e identifikuar nga Autoriteti Kontraktues; ose

- të shkatërrohet nga Ofertuesi i Mundshëm - rast në të cilin Ofertuesve të Mundshëm do tu kërkohet të shkatërrojnë menjëherë çdo informacion të tillë dhe t'i ofrojnë Autoritetit Kontraktues provë me shkrim të këtij shkatërrimi.

3.3 Përdorimi i dokumenteve të Ofertës

Të gjitha Ofertat bëhen pronë e Autoritetit Kontraktues.

Pavarësisht sa më sipër dhe pa paragjykuar ndonjë marrëveshje të mëpasshme të nënshkruar ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe ndonjë Ofertuesi të Mundshëm, pronësia e të drejtave të pronësisë intelektuale në lidhje me informacionin e gjendur në Ofertë mbeten të pandryshuara.

Autoriteti Kontraktues mund të përdorë të dhënat që përmbahen në ndonjë propozim ose të dhënat e ofruara nga një Ofertues i Mundshëm për qëllimet e Procedurës Konkurruese (përfshirë përgatitjen ose menaxhimin e çdo kontrate apo marrëveshjeje)

Autoriteti Kontraktues do të trajtojë Ofertuesit e Mundshëm në mënyrë të barabartë gjatë Procedurës Konkurruese në lidhje me konfidencialitetin dhe informacionin e ofruar prej tyre.

4. Referenca e qartë dhe përputhshmëria

Ofertuesit e Mundshëm duhet të përfshijnë në çdo dokument një referencë të qartë në faqen dhe paragrafin përkatës të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Çdo Ofertë duhet të përmbajë një Aplikim Parakualifikimi dhe të jetë në përputhje me të gjithë kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Në zbatim të paragrafit 16.3.4, çdo informacion financiar në lidhje me Procedurën Konkurruese duhet të shprehet në Euro ose Lek (por për të shmangur dyshimin nëse i njëjti informacion financiar është dorëzuar si në Euro dhe në Lek, shuma në Lek do të përdoret për qëllimin e vlerësimit dhe shuma në Euro do të shpërfillet). Nëse ndonjë element i Ofertës dorëzohet në një valutë të huaj, ajo vlerë do të vlerësohet përmes referimit ndaj monedhës vendase. Të gjitha shumat do të konvertohen duke ju referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e hapjes së Ofertave.

Të gjitha matjet duhet të shprehen në standardet ligjore shqiptare të matjes, sipas ligjit Nr. 9875, datë 14.02.2008 "Mbi Metrologjinë" (i ndryshuar).

Autoriteti Kontraktues mund të përjashtojë çdo Ofertë që nuk është përgatitur në përputhje me këtë paragraf 4.

5. Përhapja e informacionit

5.1 Deklaratat publike

Ofertuesi i Mundshëm nuk do të bëjë ndonjë deklaratë apo lëshojë ndonjë dokument ose material apo japë informacion për publikim në ndonjë media në lidhje me Procedurën Konkurruese, vlerësimin e Ofertave, pranimin e ndonjë Oferte, kryerjen e negociatave ose ndonjë njoftim caktimi të një Ofertuesi të Përzgjedhur pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues mund të përjashtojë çdo Ofertues të Mundshëm i cili nuk vepron në përputhje me këtë paragraf 5.1.

5.2 Të drejta shtesë të Autoritetit Kontraktues

Pa krijuar kufizim për të drejtat e tjera të tij gjatë Procedurës Konkurruese, Autoriteti Kontraktues mundet që, në çdo moment përpara Dorëzimit të Ofertave pa dhënë arsye:

- të japë çdo informacion shtesë apo sqarim për të gjithë Ofertuesit e Mundshëm ;
- të kërkojë informacion të mëtejshëm nga çdo Ofertues i Mundshëm rreth Ofertës së tij;
- të kërkojë sqarime nga çdo Ofertues i Mundshëm ;
- të ndryshojë strukturën ose kohën e Procedurës Konkurruese;
- të shtyjë Afatin e Dorëzimit, gjatë së cilës çdo Ofertuesi të Mundshëm do t'i jepet mundësia të ndryshojë Ofertën;
- t'i përgjigjet çdo pyetjeje të drejtuar për sqarim Autoritetit Kontraktues nga Ofertuesit e Mundshëm dhe të publikojë pyetjen dhe përgjigjen përmes Qendrës Virtuale të të Dhënave;
- të refuzojë tu përgjigjet kërkesave për informacion;
- të kërkojë një përgjigje me shkrim nga secili Ofertues i Mundshëm në lidhje me ndonjë ndryshim në Procedurën Konkurruese;
- të përsërisë, pezullojë, rivendosë apo ndërpresë Procedurën Konkurruese.

Ofertuesit e Mundshëm nuk kanë të drejtë të ngrenë pretendime ndaj Autoritetit Kontraktues, Komitetit të Vlerësimit të Ofertave, Qeverisë apo ndonjërit prej zyrtarëve, kontraktorëve, punonjësve, agjentëve apo këshilltarëve të tyre në lidhje me ushtrimin apo mos ushtrimin e ndonjëres nga të drejtat e përcaktuara në këtë paragraf 5.2.

5.3 Dokumentacioni i brendshëm

Autoriteti Kontraktues nuk është i detyruar të publikojë ndonjë dokumentacion të brendshëm (përfshirë raportet e vlerësimit apo konsultimet).

5.4 Informacioni i rremë

Çdo Ofertues i Mundshëm që jep informacion të rremë mund të përjashtohet nga Procedura Konkurruese në çdo moment. Nëse zbulohet dhënia e informacionit të rremë pas nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën të ndërpresë Kontratën e Koncesionit në përputhje me kushtet e saj.

6. Vlefshmëria dhe kostot e ofertës

6.1 Vlefshmëria e ofertës

Çdo Ofertë do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 8 (tetë) muaj pas afatit të Dorëzimit. Oferta nga Ofertuesi i Përzgjedhur do të jetë e vlefshme deri në Datën Efektive dhe Autoriteti Kontraktues do të jetë në gjendje të kërkojë që Oferta e një Ofertuesi të Mundshëm të pasuksesshëm të zgjatet për çdo kohëzgjatje deri në Datën Efektive, ku kjo zgjatje të jetë në diskrecionin e Ofertuesit të Mundshëm.

6.2 Kostot

Çdo Ofertues i Mundshëm do të përballojë kostot dhe shpenzimet e tij në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij.

Gjithashtu, shpenzimet që lidhen me koston e Procedurës Konkurruese në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit dhe konsultimit të specializuar në shumën prej 1.650.000 USD (një milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë) do të përballohen nga Ofertuesi i Përzgjedhur dhe do të paguhet drejtpërdrejt IFC-së në përputhje me dispozitat e Kontratës së Koncesionit.

Koncesionari gjithashtu do të rimbursojë kostot e Autoritetit Kontraktues që lidhen me publikimin e njoftimit të kontratës në shumën prej 20.000 (njëzet mijë) Euro brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e Njoftimit të Ofertuesit Fitues.

7. Konflikti i Interesit

7.1 Konflikti i Interesit

Një konflikt interesi do të thotë çdo çështje, rrethanë, interes apo veprim tjetër që prek Ofertuesin e Mundshëm (përfshirë zyrtarët, punonjësit, agjentët dhe nën-kontraktorët e Ofertuesit të Mundshëm), e cila mund të ndërhyjë në aftësinë e Ofertuesit e Mundshëm për të përmbushur me pavarësi dhe transparencë Kontratën e Koncesionit.

Një konflikt interesi mund të ndodhë në rastet kur:

- Ofertuesi i Mundshëm ose ndonjëri nga zyrtarët, punonjësit, agjentët ose nën-kontraktorët e tij ka një marrëdhënie (profesionale, tregtare ose personale) me ndonjë individ të përfshirë në përgatitjen e Procedurës Konkurruese ose vlerësimin e Ofertave;
- Ofertuesi i Mundshëm ose ndonjëri nga zyrtarët, punonjësit, agjentët ose nën-kontraktorët e tij ka një marrëveshje apo marrëdhënie me ndonjë organizatë ose individ e cila do të ndikojë mbi zbatimin e Kontratës së Koncesionit apo ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Ofertuesit të Mundshëm dhe Autoriteti Kontraktues në lidhje me Projektin.

Në rastin kur një Ofertues i Mundshëm bëhet i vetëdijshëm rreth ndonjë konflikti interesi ai do të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktues.

Në rast të një shfaqjeje të konfliktit të interesit, Autoriteti Kontraktues ka mundësinë që:

- të përjashtojë Ofertuesin e Mundshëm nga pjesëmarrja e mëtejshme në Procedurën Konkurruese;
- të negociojë me Ofertuesin e Mundshëm për të zgjidhur konfliktin e interesit;
- të ndërmarrë çdo veprim tjetër që konsiderohet i përshtatshëm nga Autoriteti Kontraktues.

7.2 Veprime të paligjshme

Në përputhje me legjislacionin mbi parandalimin e konfliktit të interesit dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo Ofertë të dorëzuar nga një Ofertues i Mundshëm i cili:

- ka dhënë apo synon të japë ndonjë punonjësi aktual apo të dikurshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para apo çdo formë tjetër si një stimul për të ndikuar një veprim apo vendim gjatë Procedurës Konkurruese;
- ka një konflikt interesi të pazgjidhur apo mosmarrëveshje në lidhje me Procedurën Konkurruese.

Asnjë Ofertues i Mundshëm (përfshirë agjentët dhe përfaqësuesit e tij) nuk do të kontaktojë apo të përpiqet të kontaktojë ndonjë anëtar të Autoritetit Kontraktues, ndonjë anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, apo ndonjë anëtar ose punonjës të Qeverisë së Shqipërisë ose drejtorive, ministrive, agjencive të tyre ose organeve lokale ekzekutive, në lidhje me Procedurën Konkurruese, përveç se për procedurat e përcaktuara në këtë Dokument të Procedurës Konkurruese dhe Memorandumin e Due Diligence.

Autoriteti Kontraktues do të informojë me shkrim çdo Ofertues të Mundshëm apo çdo institucion tjetër të Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me çdo veprim të paligjshëm dhe do të përfshijë çdo njoftim në raportin rreth Procedurës Konkurruese.

8. Kufizim

8.1 E drejta për të pezulluar Procedurën Konkurruese

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të pezullojë Procedurën Konkurruese në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në bazë të diskrecionit të tij pas një vendimi të marrë nga Autoriteti Kontraktues, në rastin e riorganizimit të brendshëm apo në çdo situatë tjetër të paparashikuar. Ofertuesit e Mundshëm nuk do të kenë të drejtë të marrin ndonjë kompensim ose kosto ose shpenzime në rast se Procedura Konkurruese pezullohet.

8.2 E drejta për të shpallur Procedurën Konkurruese "të pasuksesshme".

Në bazë të Nenit 33 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë këtë Procedurë Konkurruese si të pasuksesshme nëse:

- asnjë Ofertues i Mundshëm nuk është një Ofertues i Parakualifikuar;
- asnjë Ofertë nuk është në përputhje me Kërkesat e Ofertës;
- Autoriteti Kontraktues vendos që Projekti ose Ofertat nuk ofrojnë për Autoritetin Kontraktues një zgjidhje ekonomike ose të pranueshme për Projektin;
- Këshilli i Ministrave nuk miraton Kontratën e Koncesionit.

Do të konsiderohet që përmes dorëzimit të Ofertës, Ofertuesi i Mundshëm bie dakord dhe çliron Autoritetin Kontraktues, punonjësit, agjentët dhe këshilltarët e tij në mënyrë të pakthyeshme, të pakushtëzuar, të plotë dhe përfundimtare nga çdo dhe të gjitha përgjegjësitë për pretendimet, humbjet, dëmet, kostot, shpenzimet apo përgjegjësitë që lidhen apo lindin në ndonjë mënyrë nga ushtrimi i ndonjë të drejte dhe / ose plotësimi i ndonjë detyrimi këtu poshtë, bazuar në dhe/ose në lidhje me si më poshtë dhe heq dorë nga çdonjëra dhe të gjitha të drejtat dhe/ose pretendimet që mund të ketë në lidhje me këtë, qoftë aktuale apo të paparashikuara, qoftë të tanishme apo të ardhshme.

9. Informacion shtesë dhe ndryshimet në Dokumentet e Procedurës Konkurruese

9.1 Kërkesat për informacion shtesë

Ofertuesit e Mundshëm mund t'i dorëzojnë pyetje Autoritetit Kontraktues në përputhje me paragrafin 2.2.3.

Ofertuesit e Mundshëm do të identifikojnë çdo informacion të përfshirë në çdo pyetje e cila konsiderohet të jetë konfidenciale dhe arsyet për konfidencialitetin e tij. Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë konfidencialitetin e çdo informacioni përpara se të japë një përgjigje.

Autoriteti Kontraktues do të ketë diskrecionin për t'ju përgjigjur pyetjeve të dërguara nga Ofertuesit e Mundshëm dhe do të japë përgjigje në përputhje me termat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese pa bërë të ditur burimin e pyetjes apo ndonjë informacion konfidencial që lidhet me ndonjë Ofertë ose ndonjë Ofertues të Mundshëm dhe pa bërë të ditur burimin e pyetjes përveç se në rastet kur vetë pyetja zbulon identitetin e burimit.

Një Ofertues i Mundshëm do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues në rastin kur ndonjë Ofertues i Mundshëm konsideron që ka një moszbatim, gabim, paqartësi ose mospërputhje në Procedurën Konkurruese, Dokumentet e Procedurës Konkurruese ose çdo informacion i ofruar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim që Autoriteti Kontraktues të mund të bëjë çdo korrigjim që e konsideron të përshtatshëm.

9.2 Modifikimi i Dokumenteve të Procedurës Konkurruese

Autoriteti Kontraktues mund të modifikojë Dokumentet e Procedurës Konkurruese në çdo moment.

Çdo ndryshim do të përbëjë një pjesë integrale të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

10. Gabimet e paqëllimshme në Ofertë

Autoriteti Kontraktues nuk do të pranojë ndonjë ndryshim apo shtesë në një Ofertë pas Afatit të Dorëzimit. Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë përgjegjësi për ndonjë humbje apo pasojë që vjen nga një ofertë që përmban një gabim, përfshirë modelin financiar. Nëse si rezultat i auditimit e modelit financiar të Ofertuesit të Përzgjedhur duhet të ndryshohet, këto ndryshime nuk do të kenë ndikim mbi Ofertën. Nëse pas Afatit të Dorëzimit një Ofertues i Mundshëm vendos të tërheqë ofertën e tij për shkak të një gabimi, do të zbatohen dispozitat e Paragrafit 11 më poshtë dhe Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën të kërkojë Garancia e Ofertës.

11. Garancia e Ofertës

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE", i ndryshuar, secili Ofertues i Mundshëm do të ofrojë një Garanci Oferte në shumën 250.000 € (dyqind e pesëdhjetë mijë Euro).

Garancia e Ofertës do të jetë një garanci e lëshuar nga një bankë me reputacion me një vlerësim investimi prej të paktën BBB- (S&P) ose të barasvlershëm me të për banka ndërkombëtare, ose nga një nga pesë bankat më të mëdha në Shqipëri për nga totali i aseteve që është që është e regjistruar sipas rregullit në Bankën e Shqipërisë.. Garancia e Ofertës, në

formën e formularit të përcaktuar në Shtojcën 2 do të jetë e vlefshme deri në dhe përfshirë 240 (dyqind e dyzet) ditë kalendarike pas Afatit të Dorëzimit.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të kërkojë zgjatjen e vlefshmërisë së Garancisë së Ofertës të Ofertuesit të Suksesshëm në rastet kur kjo është e arsyeshme dhe e përshtatshme për një periudhë deri në 210 (dyqind e dhjetë) ditë.

Në rast se vlefshmëria e Ofertës së një Ofertuesi të pasuksesshëm zgjatet në zbatim të paragrafit 6.1 Garancia e Ofertës së këtij Ofertuesi të Mundshëm do të zgjatet për të njëjtën kohëzgjatje.

Garancia e Ofertës do të dorëzohet së bashku me Ofertën jo më vonë se Afati i Dorëzimit. Ofertat e dorëzuara pa një Garanci Oferte do të refuzohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Autoriteti Kontraktues.

Garancia e Ofertës që mbulon një Ofertë të dorëzuar nga një konsorcium do të jetë në lidhje me të gjithë konsorciumin si i tërë dhe në emër të secilit anëtar të konsorciumit.

Autoriteti Kontraktues do ta kthejë Garancinë e Ofertës të Ofertuesve të Mundshëm të pasuksesshëm sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së Garancisë së Ofertës në përputhje me këtë paragraf 11.

Autoriteti Kontraktues do ta kthejë Garancinë e Ofertës të ofertuesit të suksesshëm pas marrjes së Sigurimit të Kontratës.

Garancia e Ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues vetëm në rrethanat e mëposhtme:

- një Ofertues i Mundshëm e tërheq Ofertën e tij gjatë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës;
- Ofertuesi i Përzgjedhur nuk ofron Sigurimin e Kontratës dhe/ose nuk nënshkruan Kontratën e Koncesionit brenda afateve të specifikuar në Njoftimin e Deklarimit të Ofertuesit të Përzgjedhur.
- një Ofertues i Mundshëm ka ofruar apo është përpjekur të ofrojë çdo lloj shpërblimi për punonjësit e Autoritetit Kontraktues të cilët kanë lidhje me Projektin;
- një Ofertues i Mundshëm ka bërë deklarime të pavërteta në ofertën e tij;
- Ofertuesi i Përzgjedhur nuk bën pagesat në përputhje me paragrafin 6.2 brenda periudhës të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

12. Vlerësimi i Ofertave

Ofertat e Ofertuesve të Parakualifikuar do të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Ofertat do të vlerësohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafët 16 dhe 17.

Në rastin kur dorëzohet vetëm një ofertë sipas kërkesave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjithsesi do të ketë të drejtën të refuzojë ose pranojë atë Ofertë në përputhje me këto Dokumente të Procedurës Konkurruese.

Në rastin kur dy ose më shumë Ofertues të Parakualifikuar, të cilët secili marrin një vlerësim kalues të Ofertave të tyre Teknike, vlerësohen me pikë identike në lidhje me Ofertën Financiare

("Ofertuesit e Barabartë"), Autoriteti Kontraktues do të identifikojë Ofertuesin e Përzgjedhur duke ftuar Ofertuesit e Barabartë të dorëzojnë ofertën e tyre më të mirë dhe përfundimtare. Një ofertë e tillë do të dorëzohet duke përdorur të njëjtët formularë si në Ofertën origjinale dhe duhet të merret nga Autoriteti Kontraktues brenda asaj periudhe të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Në rastin kur Ofertat Financiare të Ofertuesve të barabartë mbeten identike, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtën të përsërisë procesin deri sa Ofertat Financiare të arrijnë pikë të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur bazuar në urdhrin e Autoritetit Kontraktues në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE", i ndryshuar. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të përgatisë një raport për Autoritetin Kontraktues rreth rekomandimeve të tij në lidhje me Ofertat. Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave do të jetë informativ për Autoritetin Kontraktues me rekomandime në lidhje me Ofertuesin e Përzgjedhur.

13. Roli i institucioneve dhe ekspertëve të tjerë shtetërorë

Autoriteti Kontraktues ose Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojnë çdo asistencë ose këshillim nga institucione ose ekspertë të tjerë shtetërorë (përfshirë ligjore, financiare ose teknike) gjatë procesit të vlerësimit të Ofertave.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shqyrtojë çdo sugjerim, vlerësim ose këshillë të dhënë nga institucione ose ekspertë të tjerë shtetërorë si një pjesë e vlefshme e procesit të vlerësimit të Ofertave.

14. Siguria, integriteti dhe kontrole të tjerë

Autoriteti Kontraktues mund të kryejë një hetim të arsyeshëm apo procedurë të ngjashme që e konsideron të nevojshme për të shqyrtuar integritetin dhe financimin që lidhet me një Ofertë ose Ofertuesin e Parakualifikuar.

Ofertuesi i Parakualifikuar do të ofrojë menjëherë çdo informacion ose ndihmë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim që çdo hetim i nevojshëm të kryhet. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përjashtojë çdo Ofertë nga vlerësimi i mëtejshëm nëse një Ofertues i Parakualifikuar nuk jep informacionin e kërkuar ose ndihmë të arsyeshme Autoritetit Kontraktues.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të ketë të drejtë të bëjë pyetje Ofertuesve të Parakualifikuar në mënyrë të pavarur në lidhje me çdo çështje që ai e konsideron të rëndësishme për vlerësimin e Ofertave.

15. Kalendari i punës

Kalendari për Procedurën Konkurruese është si më poshtë:

1.	Nxjerrja e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese	15 Shkurt 2016
2.	Nxjerrja e draft Kontratës së Koncesionit	15 Shkurt 2016
3.	Afati për dorëzimin e kërkesave fillestare për qartësim dhe komente	22 Shkurt 2016

4.	Konferenca e Ofertuesve të Mundshëm (Tiranë)	29 Shkurt 4 Mars 2016
5.	Afati për dorëzimin e kërkesave shtesë për sqarime dhe komente përpara nxjerrjes së draftit final.	27 Prill 2016
6.	Nxjerrja e Dokumenteve përfundimtare të Procedurës Konkurruese	29 Prill 2016
7.	Afati i Dorëzimit	30 Maj 2016

Autoriteti Kontraktues ka të drejtën të ndryshojë kalendarin për Procedurën Konkurruese bazuar në paragrafin 5.2. Të gjitha ndryshimet e kalendarit për Procedurën Konkurruese do tu njoftohen Ofertuesve të Mundshëm përmes Qendrës Virtuale të të Dhënave dhe/ose me e-mail.

16. Dokumentet e Ofertës dhe Kërkesat e Ofertës

16.1 Dokumentet e Ofertës

Dokumentet e Ofertës përfshijnë:

- (a) Aplikimi i Parakualifikimit në përputhje me Kërkesën për Kualifikim
- (b) Oferta Ligjore
- (c) Oferta Teknike
- (d) Oferta Financiare

16.2 Oferta Ligjore

16.2.1 Ofertuesit e Mundshëm do të japin Formular të Deklarimit të Ofertës (Shtojca 1), i cili përfshin, ndërmjet të tjerave, një deklaratë që konfirmon se ata pranojnë termat e Kontratës së Koncesionit (siç është ndryshuar në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese, nëse vlen) siç janë hartuar. Në rast se Ofertuesi i Mundshëm është një Konsorcium, Shtojca 1 -- Formulari i Deklarimit të Ofertës duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i secilit anëtar të Konsorciumit.

16.2.2 Ofertuesit e Mundshëm do të japin kopje të certifikuara të vendimit të bordit të drejtorëve, aksionerëve dhe/ose organeve drejtuese përkatëse të Ofertuesit të Mundshëm (me noterizimin dhe legalizimin/apostilën përkatëse) për dorëzimin e Ofertës dhe miratimin nga Ofertuesi i Mundshëm të lidhjes dhe zbatimit të Kontratës së Koncesionit. Në rastin e një Konsorciumi, këto vendime do të kërkohen nga secili prej anëtarëve të Konsorciumit.

16.2.3 Ofertuesit e Mundshëm do të japin një autorizim përfaqësimi i cili do të jetë apostil/i legalizuar (nëse ekzekutohet në prani të një Autoriteti Publik) në mënyrë të rregullt siç përcaktohet në Shtojcën 7.

- 16.2.4 Ofertuesit e Mundshëm do të japin Garancinë e Ofertës në formën e përcaktuar në Shtojcën 2 këtu.

16.3 Oferta Teknike

Secili Ofertues i Mundshëm do të japë një Propozim për Punimet e Ndërtimit dhe një Propozim për Shërbimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes, siç specifikohet më poshtë:

- 16.3.1 Propozimi për Punimet e Ndërtimit, minimalisht, duhet të përfshijë seksionet dhe përmbajtjen e mëposhtme:

- (a) Punime Fillestare Gjeoteknike: (i) lista e punimeve për tu kryer, e cila duhet të jetë në përputhje me listën e specifikuar në Programin 6 të draft Kontratës së Koncesionit, (ii) një përshkrim të shkurtër të metodave dhe teknikave për tu përdorur për projektimet e detajuara dhe ekzekutimin e punimeve dhe përvojës së nënkontraktorëve dhe ekipit të menaxhimit të projektit me punimet e stabilizimit të shpateve, (iii) një kornizë kohore për zbatimin e punimeve, e cila duhet të jetë në përputhje me afatet e përfundimit të ndërtimit të përcaktuara në Klauzolën 6.2.2 të Programit 5 të Kontratës së Koncesionit, dhe (iv) një Preventiv me Çmime (i cili për shmangien e dyshimit do të përdoret si për Punimet Gjeoteknike fillestare dhe për Urën e Kukësit), në formatin e përcaktuar në Shtojcën 14 të Dokumentit të Procedurës Konkurruese dhe pastaj në Programin 7 të draft Kontratës së Koncesionit.
- (b) Ura e Kukësit: (i) një plan dhe një kornizë kohore për zbatimin e studimeve inxhinierike dhe projekteve të detajuara dhe punimeve të mëpastajshme të ndërtimit, që duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në draft Kontratën e Koncesionit, (ii) përvojën përkatëse të nënkontraktorëve kryesorë dhe ekipit të menaxhimit të projektit, (iii) një kornizë kohore për zbatimin e punimeve, e cila duhet të jetë në përputhje me afatet e përfundimit të ndërtimit të përcaktuara në Klauzolën 6.2.2 të Programit 5 të Kontratës së Koncesionit, dhe (iv) një Preventiv me Çmime në formatin e përcaktuar në Shtojcën 7 të draft Kontratës së Koncesionit (i cili për shmangien e dyshimit do të përdoret si për Urën e Kukësit ashtu dhe për Punimet Gjeoteknike fillestare).
- (c) Punime të tjera (i) një listë dhe një përshkrim të shkurtër të punimeve të tjera, përfshirë sheshin e pagesës, O&M dhe ndërtesat administrative, mjediset dhe pajisjet, (ii) një plan dhe kornizë kohore për projektimin, prokurimin dhe ekzekutimin e tyre, dhe (iii) një plan dhe kornizë kohore për prokurimin e ekipit të menaxhimit të projektit.

- 16.3.2 Propozimi për Shërbimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes, minimalisht, duhet të përfshijë seksionet dhe përmbajtjen e mëposhtme:

- (a) Organizimi: një grafik organizativ të Koncesionarit, përfshirë njësitë kryesore administrative, një përshkrim të shkurtër të pozicioneve kyç drejtuese dhe teknike, emrat dhe të dhënat e përvojës së personelit kyç, dhe numrat e përafërt totalë të personelit në njësitë kryesore organizative.
- (b) PAGESA: një plan i përgjithshëm i mbledhjes së pagesave, përfshirë përshkrime të shkurtra të metodave dhe teknologjive për tu përdorur,

të sistemeve administrative, të kontrollit dhe raportimit që do ngrihen, dhe të përbërjes së personelit dhe ekipit mbikëqyrës.

- (c) Kontrolli i Trafikut: një plan i përgjithshëm për kontrollin e trafikut dhe ndihmës për përdoruesit, përfshirë trajtimin e emergjencave dhe mbylljet e korsive, përllogaritjet e personelit dhe kërkesave për burime të tjera.
- (d) Mirëmbajtja Rutinë: plan i përgjithshëm për aktivitetet e inspektimeve dhe mirëmbajtjes rutinë, përfshirë ato për mirëmbajtjen dimërore, përfshirë përshkrime të shkurtra të metodave dhe teknikave për tu përdorur, sistemet e planifikimit, kontrollit dhe raportimit, monitorimi dhe vlerësimi i performancës, përllogaritja e kërkesave për personel dhe burime të tjera.
- (e) Mirëmbajtja Kryesore: një përshkrim i shkurtër i qasjes së përgjithshme ndaj monitorimit të kushteve të aseteve dhe planifikimit dhe kryerjes së mirëmbajtjes kryesore, veçanërisht shtrojave të rrugës, strukturave dhe tunelit të Thirrës, dhe përllogaritjet e personelit dhe burimet e tjera që do të caktohen për këto aktivitete.
- (f) Sigurimi i Cilësisë: një përshkrim të qasjes së propozuar për kontrollin e cilësisë, përfshirë procedurat, metodat, personeli dhe burime të tjera për të siguruar cilësinë e punimeve të ndërtimit dhe shërbimet e operimit dhe mirëmbajtjes në përputhje me kërkesat kontraktuale, përfshirë aspektet e tyre mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë. Pritet që sistemet e propozuara të plotësojnë standardet përkatëse ISO, edhe nëse certifikimi ISO nuk është një kërkesë.

16.3.3 Preventivet me Çmime referuar në seksionet 16.3.1 (a) dhe (b) do të përdoren për të llogaritur shumat e pagesave të kompensimit që lidhen me urdhrat e ndryshimeve të ardhshme ose rastet e pranueshme të kompensimit siç përcaktohen në draft Kontratën e Koncesionit. Të gjithë çmimet e njësisve të propozuar nga Ofertuesi i Përzgjedhur do të jenë në Euro dhe do të jenë subjekt i shqyrtimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me synimin e përcaktimit nëse këto çmime njësisish janë (i) në përputhje me përllogaritjet e kostos së ndërtimit të Ofertuesit të përfshirë në Modelin Financiar të tij; (ii) kryesisht në përputhje me çmimet referuese të njësisve të publikuara së fundmi në Manualin e Çmimeve për Njësi të Ndërtimit; dhe (iii) kryesisht në përputhje me çmimet e njësisve që mbizotërojnë në treg. Në rast se një ose më shumë çmime të njësisve të ofruara nga Ofertuesi i Përzgjedhur do të përcaktohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave që nuk kanë arritur çdo një ose më shumë prej (i), (ii) ose (iii) më lart, Ofertuesit të Përzgjedhur do t'i kërkohet të paraqesë një Preventiv me Çmime të rishikuar. Nëse Preventivi me Çmime i rishikuar përsëri gjykohet që nuk ka arritur çdo një prej (i), (ii) ose (iii) më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të refuzojë ofertën e tij.

16.4 Oferta Financiare

16.4.1 Subvencioni i Autoritetit Kontraktues

Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë formularin e përcaktuar në Shtojcën 10 të këtij Dokumenti të Procedurës Konkurruese, që përmban shumën e Subvencionit të Autoritetit Kontraktues të kërkuar nga Ofertuesi i Mundshëm për vitet tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) të Periudhës së Koncesionit (përfshirëse). Subvencioni i

Autoritetit Kontraktues duhet të indeksohet bazuar në mekanizmin e definuar në Kontratën Koncesionit..

16.4.2 Modeli Financiar

Ofertuesit e Mundshëm do të dorëzojnë një model financiar të hartuar dhe ndërtuar në përputhje me praktikën e përgjithshme të pranuar të sektorit për koncesionet e rrugëve me pagesë të financuara në bazë të një financimi projekti dhe kërkesat e Shtojcës 11. Modeli financiar i Ofertuesit të Përzgjedhur do të auditohet dhe do të bëhet Modeli Financiar Referencë pas rishikimit dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktues. Një dokument format bazë përpunimi të dhënash (spreadsheet) është dhënë përmes Qendrës Virtuale të të Dhënave, i cili duhet të përbëjë pjesë të modelit financiar të audituar të Ofertuesve të Mundshëm. Nëse spreadsheet format bazë, e pandryshuar, nuk është pjesë e një modeli financiar të një Ofertuesi të Mundshëm, atëherë Oferta e këtij Ofertuesi të Mundshëm do të jetë e pavlefshme.

Për qëllimin e këmbimit Euro / Lek në modelet e tyre financiare, Ofertuesit e Mundshëm do të përdorin Kursin Zyrtar të Këmbimit Euro / Lek të shfaqur në faqen e internetit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë në orën 3:00.MD në datën e cila bie 7 (shtatë) ditë kalendrike përpara Afatit të Dorëzimit.

Ofertuesit e Mundshëm do të përdorin norma vjetore fikse të shkëmbimit të Euros ekuivalente të EURIBOR/LIBOR 6 mujor me afat sipas preferencës së Ofertuesit, siç publikohet nga ICAPEURO në orën 10:00 Londër/11:00 Frankfurt 7 (shtatë) ditë kalendrike përpara Afatit të Dorëzimit si supozime të Normës Bazë në Modelet e tyre Financiare. Autoriteti Kontraktues do të konfirmojë listën e Normave bazë me shkrim për Ofertuesit e Mundshëm dhe do të japë një kopje të shtypur të kurbave përkatëse të cilat mund të përdoren për qëllimin e përcaktimit të Normave bazë jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara Afatit të Dorëzimit.

17. Vlerësimi

17.1 Kriteret e Vlerësimit

Ofertat do të vlerësohen deri në çfarë shkalle ato plotësojnë kërkesat dhe objektivat e Autoritetit Kontraktues për Projektin, të përcaktuara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese:

- Oferta Ligjore

Ofertat Ligjore do të vlerësohen në një bazë Kalon / Ngel. Ofertat Ligjore të cilat japin të gjithë dokumentet e specifikuar në Seksioni 16.2 më sipër dhe përcaktohen si të kënaqshme nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të përcaktohen si Kalon. Ofertat Ligjore me një ose më shumë dokumente që mungojnë apo jo të kënaqshme do të përcaktohen si Ngel.

- Oferta Teknike

Ofertat Teknike do të vlerësohen në një bazë Kalon / Ngel. Ofertave Teknike do të marrin një Kalon nëse ato përmbajnë të gjithë seksionet e specifikuar në Seksionin 16.3 më sipër, përfshijnë të gjithë përmbajtjen e cila është specifikuar për secilin seksion, dhe janë përcaktuar përndryshe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave që t'i përgjigjen në thelb Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, përfshirë Seksionet dhe Programet përkatëse të draft Kontratës së Koncesionit.

Ofertat teknike me një ose më shumë seksione që mungojnë apo jo të kënaqshme do të marrin një Ngel.

- **Oferta Financiare**

Ofertat Financiare do të vlerësohen në bazë të Subvencionit të Autoritetit Kontraktues të kërkuar.

Ofertat Financiare do të renditen sipas Kriterit Financiar nga më e ulëta (më e mira) tek më e larta (më e keqja).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vlerësojë secilën Ofertë përkundrejt secilit prej këtyre kritereve dhe do të ndërmarrë një vlerësim krahasues të Ofertave me qëllim dhënien e një rekomandimi Autoritetit Kontraktues se cila Ofertë përbën zgjidhjen më të mirë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë paragraf.

17.2 Vlerësimi i Ofertave Financiare

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk do të vlerësojë ofertën Financiare nëse një Ofertues i Parakualifikuar nuk ka marrë një Kalon për të gjithë elementet e Ofertës Ligjore dhe Ofertës Teknike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vlerësojë Ofertat Financiare për të gjithë Ofertuesit e parakualifikuar të cilët marrin një Kalon për Ofertën Ligjore dhe Ofertën Teknike. Renditja e Ofertave Financiare në përputhje me paragrafin 17.1 do të përcaktojë renditjen finale të këtyre Ofertuesve të Parakualifikuar.

17.3 Procesi për vlerësimin

Në kryerjen e vlerësimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe/ose Autoriteti Kontraktues:

- mund të marrin në konsideratë informacionin e dhënë nga Ofertues i Parakualifikuar në përgjigje të një kriteri në vlerësimin e një kriteri tjetër;
- nuk do t'i kushtojnë vëmendje rendit të kritereve të vlerësimit; dhe
- kanë të drejtë të kërkojnë sqarime dhe informacion shtesë jo-thelbësor nga Ofertuesit e Parakualifikuar për aq sa një Ofertë të jetë e paqartë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Autoriteti Kontraktues rezervojnë të drejtën të përjashtojnë një Ofertë nga vlerësimi nëse gjejnë që Oferta është e paplotë ose nuk përputhet me Kërkesat e Procedurës Konkurruese.

18. Procedura e apelimit

Një Ofertues i Parakualifikuar mund të kërkojë një rishikim administrativ të procesit të vlerësimit nëse ai konsideron që një veprim i marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave apo Autoriteti Kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e Legjislacionit të Koncesioneve apo legjislacion tjetër të zbatueshëm.

Në bazë të Nenit 32 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE

NACIONALE", i ndryshuar, një Ofertues i Parakualifikuar mund të dorëzojë një ankesë në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së Ofertuesit të Përzgjedhur dhe renditjes së Ofertuesve të Parakualifikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Me marrjen e kërkesës Komisioni i Vlerësimit të Ofertave merr një vendim nëse të pezullojë Procedurën Konkurruese dhe procedurat e koncesionit me qëllim që të fillojë procedurat e hetimit administrativ dhe do të njoftojë Autoritetin Kontraktues brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike.

Komisioni i Prokurimeve Publike nuk do të pezullojë Procedurën Konkurruese dhe procedurat e koncesionit nëse:

- një shqyrtim paraprak i kërkesës përcakton që nuk është ligjërisht i shëndoshë; ose
- pezullimi është në kundërshtim me interesin publik.

Përpara lidhjes së Kontratës së Koncesionit, Komisioni i Prokurimeve Publike ka të drejtë:

- të anulojë tërësisht ose pjesërisht vendimet apo aktet e Autoritetit Kontraktues;
- të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të korrigjojë shkeljet përpara se të vazhdojë me Procedurën Konkurruese dhe procedurat e koncesionit.

Gjatë çdo hetimi administrativ, Komisioni i Prokurimeve Publike do të ketë të gjitha kompetencat e dhëna atij nga Ligji por do të kryejë këtë proces në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Çdo pretendim drejtuar Komisionit të Prokurimeve Publike do të bëhet në formatin e përshtatshëm (Shtojca 6 e bashkëngjitur këtu) duke dhënë emrin dhe adresën e kërkuarit, referenca për procedurën përkatëse, bazën ligjore dhe një përshkrim të shkeljes.

Çdo kërkesë do të shoqërohet nga një paradhënie prej 10% (dhjetë për qind) të vlerës së Garancisë së Ofertës. Në rastin kur nuk është dhënë një paradhënie Komisioni i Prokurimeve Publike do të refuzojë të fillojë një hetim administrativ. Paradhënia do t'i kthehet kërkuarit nëse kërkesa pranohet. Nëse një kërkesë nuk ka sukses paradhënia mbahet nga Qeveria e Shqipërisë.

Komisioni i Prokurimeve Publike do të marrë një vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike të marrjes së një kërkesë dhe do ta njoftojë kërkuarin dhe Autoritetin Kontraktues mbi vendimin. Kërkuari mund të apelojë vendimin e Komisionit të Prokurimeve Publike në gjykatën kompetente mbi bazë administrative brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i vendimit.

19. Nënshkrimi i Kontratës së Koncesionit

- 19.1 Nuk do të ketë negociata ndërmjet Ofertuesit të Përzgjedhur dhe Autoritetit Kontraktues në lidhje me ndonjë term material të Kontratës së Koncesionit, duke përfshirë por jo kufizuar në kushtet kryesore të koncesionit të përcaktuara në paragrafin 1.6, strukturën e çmimit të projektit, alokimin e rrezikut dhe termave kryesore tregtare, dhe Kontrata e Koncesionit do të lidhet materialisht në formularin e bashkëngjitur në Shtojcën 8 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese

- 19.2 Kontrata e Koncesionit do të ndryshohet vetëm atëherë sa kërkohet me qëllim që: (i) të pasqyrojë Ofertën e Ofertuesit të Përzgjedhur dhe amendimet e kërkuara për të trajtuar ndryshimet pasuese, duke përfshirë, nëse vlen, ndryshimet të cilat janë identifikuar përpara Afatit të Dorëzimit në dokumentin e përgjigjeve ndaj pyetjeve; (ii) të plotësojë çdo boshllëk; (iii) të korrigjojë gabimet dhe harresat.
- 19.3 Pas plotësimit të procedurës së vlerësimit dhe njoftimit të caktimit të Ofertuesit të Përzgjedhur, Autoriteti Kontraktues cakton një afat për ekzekutimin e Kontratës së Koncesionit që është parashikuar të jetë jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga nxjerrja e vendimit në fjalë. Ky afat mund të zgjatet sipas gjykimit dhe me vendim të Autoritetit Kontraktues.
- 19.4 Ofertuesi i Përzgjedhur do të angazhohet në dorëzimin e Ofertës së tij që në rast se caktohet si Ofertuesi i Përzgjedhur, do të përfshijë një Special Purpose Vehicle ("SPV") në përputhje me legjislacionin shqiptar për tu miratuar nga Autoriteti Kontraktues, për zbatimin e Projektit, që do të lidhë një marrëveshje për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar me Ofertuesin e Përzgjedhur në lidhje me Kontratën e Koncesionit dhe do të marrë të gjithë të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesit të Përzgjedhur ashtu sikur SPV të kishte qenë fillimisht Ofertuesi i Përzgjedhur dhe të kishte lidhur Kontratën e Koncesionit.

20. Negociatat e pasuksesshme me Ofertuesin e parë të Përzgjedhur

- 20.1 Në bazë të Nenit 34 paragrafi 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar, në rastet kur Autoriteti Kontraktues vendos që negociatat me Ofertuesin e Përzgjedhur të parë nuk do të përmbillen me nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të ftojë në negociata Ofertuesin e Parakualifikuar të renditur të dytin, dhe nëse dështon të arrijë një marrëveshje edhe me Ofertuesin e Parakualifikuar të renditur të dytin, atëherë fton Ofertuesin e Parakualifikuar të renditur të tretë e kështu me radhë.
- 20.2 Autoriteti Kontraktues mundet që në diskrecion absolut të refuzojë të hyjë në negociata me ndonjërin apo të gjithë Ofertuesit e Parakualifikuar të mbetur në rastin kur negociatat dështojnë me Ofertuesin e Përzgjedhur të parë dhe Ofertuesi i Përzgjedhur i parë nuk ekzekuton Kontratën e Koncesionit.

Shtojca 1

Formulari i Deklarimit të Ofertës

Ref: []

Data: []

Për: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë.

Procedura e Prokurimit: []

Përshkrim i shkurtër i Projektit: Projekti PPP i Autostradës Milot – Morinë

Duke iu referuar Procedurës Konkurruese të sipërpërmendur, ne, të nënshkruarit deklarojmë që:

1. pasi kemi shqyrtuar Dokumentet e Procedurës Konkurruese, ne pranojmë pa rezerva kërkesat, afatet dhe kushtet e deklaruar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
2. ne plotësojmë të gjitha kërkesat ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të deklaruar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
3. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e deklaruar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
4. nëse oferta jonë pranohet ne do të japim Sigurim Kontrate në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
5. ne nuk do të marrim pjesë si Ofertues i Mundshëm në më shumë se një Ofertë për këtë Projekt;
6. ne autorizojmë Autoritetin Kontraktues të verifikojë informacionin dhe dokumentet e bashkëngjitur kësaj Oferte;
7. në pranojmë të nënshkruajmë Kontratën e Koncesionit në formën e draft Kontratës së Koncesionit (siç rregullohet në përputhje me paragrafin 19.2 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese) nëse ne jemi Ofertuesi i Përzgjedhur;
8. ne kuptojmë që ju mund të anuloni Procesin Konkurrues në çdo moment, që ju nuk jeni të detyruar të pranoni asnjë Ofertë që ju mund të merrni dhe që ju i ftoni Ofertuesit e Mundshëm të konkurrojnë për Projektin pa marrë përsipër asnjë përgjegjësi ndaj Ofertuesve të Mundshëm, në përputhje me paragrafin 8 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Ne pranojmë dhe kuptojmë që Oferta u nënshtrohet dispozitave të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Në asnjë rast ne nuk do të kemi pretendime apo të drejtë të çfarëdo lloji natyre nëse Koncesioni nuk na jepet ne.

Anëtari i Konsorciumit:

Nënshkrimi:

Vula:

Shtojca 2

Formulari i Garancisë së Ofertës

Garancia Bankare

Nr. ref. _____

Datë []

Përfituesi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë.

Ne jemi informuar se _____ (i/e quajtur këtej e tutje "Ofertuesi") është kërkuar nga ju që të paraqesë para Autoritetit Kontraktues një Garanci të Ofertës në shumën prej [shuma në shifra dhe fjalë] si kusht për lejimin e Ofertuesit për të marrë pjesë në ofertën e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të Republikës së Shqipërisë në lidhje me Projektin PPP të Autostradës Milot – Morinë.

Ne, [Emri i Bankës], marrim përsipër në formë të pakthyeshme të paguajmë për ju një shumë që nuk tejkalon [shumën dhe monedhën në fjalë dhe shifra], pavarësisht nga ndonjë kundërshtim nga ana e Ofertuesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas pranimit nga ne të kërkesës tuaj të parë me shkrim bërë në përputhje me procedurën e kërkesës detajuar më poshtë.

Kërkesa juaj duhet të pranohet nga ne me ose para [shëno datën e skadimit] dhe duhet të shoqërohet me ose përfshijë deklaratën tuaj si më poshtë:

"Ne vërtetojmë se shumën e kërkuar është e pagueshme për shkak se [emri ofertuesit] nuk plotëson detyrimet e tij në përputhje me termat dhe kushtet e ofertës Nr [shëno numrin]

Çfarëdo kërkesë sipas kësaj Garancie duhet të dorëzohet në mënyrën e mëposhtme:

I. me letër, me nënshkrimin (et) në kërkesën e legalizuar nga bankierët tuaj ose

II. nga bankier juaj me swift / teleks të testuar, ose mjete të tjera të njohura të vërtetuara të teletransmisionit.

Një kërkesë paraqitur me anë faksit nuk do të pranohet.

Çdo kërkesë dhe deklaratë e bërë në përputhje me procedurën e mësipërme të kërkesës do të pranohet si provë bindëse se shumën e pretenduar është e pagueshme tek ju sipas kësaj Garancie.

Gjithmonë me kusht që:

1. Përgjegjësia jonë në këtë Garancia është e kufizuar në një shumë që nuk kalon në total [shëno monedha dhe vlera në fjalë dhe shifra]

2. Kjo garanci do të përfundojë më 24.01.2017 dhe çdo kërkesë dhe deklaratë duhet të pranohet nga ne në këtë zyrë në përputhje me procedurën e mësipërme të kërkesës në ose para kësaj date, pas të cilës do të bëhet e pavlerë në qoftë se kthehet tek ne apo jo.

Kjo Garanci është personale për veten tuaj dhe nuk është e transferueshme apo nuk mund të tjetërsohet.

Kjo Garanci është subjekt i Rregullores Uniforme për Garancitë Demand, ICC Publikimi Nr 758

Nënshkrimi dhe vula e Bankës

Shtojca 3

Nuk Përdoret.

Shtojca 4

Formulari i Njoftimit të Ofertuesit të Përzgjedhur

Data: _____

Për: (Emri dhe adresa e Ofertuesit të Mundshëm)

Përshkrim i Shkurtër i Procedurës së Prokurimit:

Ne ju informojmë se, Ofertuesit e Mundshëm të mëposhtëm kanë qenë pjesëmarrës në tender duke ofruar përkatësisht:

1. _____ Vlera (numri dhe fjalët) _____
2. _____ Vlera (numri dhe fjalët) _____
3. _____ Vlera (numri dhe fjalët) _____
- 4.....

Janë skualifikuar Ofertuesit e Mundshëm të mëposhtëm:

1. _____
2. _____

Arsyet e Skualifikimit: _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë njofton [*emri dhe adresa e Ofertuesit të Përzgjedhur*] se Oferta e paraqitur në [*datë*] në lidhje me Projektin PPP të Autostradës Milot – Morinë është pranuar.

Brenda [] ditëve Ofertuesit [*emri*] i kërkohet të paraqesë në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë:

- Një kopje të nënshkruar të Njoftimit të Ofertuesit të Përzgjedhur.
- Sigurimin e Kontratës në përputhje me Kontratën e Koncesionit.
- Të bëjë pagesën në përputhje me paragrafin 6.2 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese në numrin e llogarisë bankare 2000192003476 at WELLS FARGO BANK, N.A. (të njohur më përpara si WACHOVIA) ose në një bankë tjetër në atë vend që IFC mund të përcaktojë kohë pas kohe.

Në rast se Ofertuesi nuk dëshiron të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit, ju do të njoftoni Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë me shkrim. Në këtë rast Sigurimi i Ofertës do të kërkohet nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues

[*emri, nënshkrimi dhe vula*]

Shtojca 5

Formulari i Njoftimit Standard të Ofertuesit të Skualifikuar

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues]

[Adresa e Ofertuesit]

I/E nderuar Z./Zj. <emri i personit të kontaktit>

Ne ju falënderojmë për pjesëmarrjen në procedurën e sipërpërmendur, e cila është ekzekutuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar.

Oferta juaj u vlerësua saktësisht në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e ofertuesit.

Me keqardhje ju informojmë që ju jeni [skualifikuar], për shkak të arsyes(ve) të mëposhtme [shënimi kutinë përkatëse]:

[subjekti juaj] [menaxheri juaj ekzekutiv]

morën pjesë në hartimin e njoftimit të kontratës, apo dosjes së tenderit, apo pjesëve të saj, të cilat u përdorën nga Autoriteti Kontraktues

morën ndihmë të paligjshme në hartimin e njoftimit të kontratës, apo dosjes së tenderit, apo pjesëve të saj

[subjekti juaj]

është gjykuar nga një gjykatë kompetente që ka kryer një shkelje penale ose civile, përfshirë praktikën korruptive, pastrim parash, organizim kriminal apo aktivitete të tjera të përcaktuara në ligjet apo rregullat e zbatueshme shqiptare, apo në bazë të marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;

Një gjykatë kompetente ka vendosur që ka kryer një vepër mashtrimi apo një vepër tjetër të barasvlershme me mashtrimin;

është dënuar nga një gjykatë kompetente për arsye që lidhen me sjelljen profesionale;

është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruar në Legjislacionin në fuqi;

Ka falimentuar dhe aktiviteti i tij është në administrimin e gjykatës, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar;

është në procedurën e deklarimit të falimentit, në bazë të një urdhri të likuidimit të detyruar apo administrimit nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, apo sipas procedurave të ngjashme, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar.

Është dënuar me një vendim të formës së prerë për shkelje që lidhen me sjelljen profesionale;

Nuk ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore, në përputhje me Legjislacionin e Shqipërisë dhe dispozitat në fuqi në vendin e origjinës;

Nuk ka plotësuar detyrimet në lidhje me pagesën e taksave, në përputhje me Legjislacionin e Shqipërisë ose dispozitat në fuqi në vendin e origjinës;

Ju nuk dorëzuar:

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar që ju keni dorëzuar dokumente që përmbajnë informacion të rremë apo dokumentacion të rremë me qëllim që të kualifikoheni;

Nuk mundët të plotësoni kërkesën për garancinë e ofertës;

(çdo arsye tjetër përveç atyre të mësipërme)

JUSTIFIKIMI

[Ju jeni skualifikuar] [Oferta juaj u refuzua] për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[Fusni arsyet e detajuara për skualifikimin apo refuzimin e ofertës në fjalë]

Nëse ju mendoni që Autoriteti Kontraktues ka shkelur Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar, gjatë procedurës konkurruese, atëherë ju keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në të. Megjithëse ne nuk mund të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, ne shpresojmë që ju do të vazhdoni të jeni të interesuar në nismat tona konkurruese.

(AUTORITETI KONTRAKTUES)

Shtojca 6

Formulari i Ankimit i Procedurës Konkurruese

Ankim i drejtuar: Komisionit të Prokurimeve Publike, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar.

SEKSIONI I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi duhet të jetë një Ofertues (p.sh. një subjekt, partneritet, në bashkëpunim, ose një konsorcium kompanish).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutemi shtypeni)

Adresa:

Qyteti:

Shteti:

Kodi postar:

Nr. i telefonit (përfshirë prefiksin e zonës):

Nr. i faksit (përfshirë prefiksin e zonës):

E-mail:

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar i cili do të plotësojë ankesën (ju lutemi shtypeni):

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar:

Data (viti/muaji/dita):

Nr. i telefonit (përfshirë prefiksin e zonës):

Nr. i faksit (përfshirë prefiksin e zonës):

SEKSIONI II. Informacion mbi Procedurën

1. Nr identifikimit:

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës apo Dokumentet e Procedurës Konkurruese, përfshirë llojin e procedurës të përdorur për konkurrimin e përzgjedhur (koncesion)

2. Autoriteti Kontraktues:

Emri i Autoritetit Kontraktues që menaxhon procesin konkurrues

3. Vlera e prokurimit:

Llogaritja e vlerës së kontratës (shumë e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Kontratës:

Përshkrim i shkurtër.

5. Afati për dorëzimin e ofertës:

Afati për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e përcaktimit të kontratës fituese:

Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme

SEKSIONI III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore për Ankesën

(shkruani shkëlqen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. Deklarim i Hollësishëm i Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaram të hollësishëm të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj Për çdo arsye të ankesës, ju lutemi specifikoni datën në të cilën ju u bëtë i vetëdijshëm për faktet që lidhen me arsyet e ankesës. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

SEKSIONI IV. Kundërshtimi paraprak i Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e adresuar drejtpërdrejt Autoritetit Kontraktues Bashkëngjitni një kopje të çdo ankese me shkrim, përfshirë përgjigjen, nëse ka një të tillë.

1. A keni paraqitur ndonjë ankesë të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e refuzimit (p.sh. me shkrim, faks, etj.).

Po / Jo

2. Autoriteti Kontraktues ku është bërë ankesa:

Emri i Autoritetit Kontraktues:

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit bëhet kundërshtimi:

3. Natyra e Masës Korrigjuese të Kërkuar

Çfarë mase korrigjuese kërkuat?

4. Lista

Që një ankesë të merret parasysh ajo duhet të jetë e plotë. Bashkëngjitni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumenteve që lidhen me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjithë Dokumentet e Procedurës Konkurruese, me të gjitha amendimet dhe shtojcat, propozimin tuaj, të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që ju keni bërë. Përcaktoni cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni përse informacioni është konfidencial ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse ku pjesët konfidenciale janë hequr dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Dërgoni formularin e plotësuar të ankesës, të gjithë shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, në: autoritetin e duhur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 634, datë 1/10/2014, i ndryshuar.

Nr i Faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe Vula e Ankimuesit

Shtojca 7

Formulari i Autorizimit të Përfaqësimit

Autorizim Përfaqësimi

Në këtë ditë [] të []

Përpara meje

Noteri në këtë zyrë

Të nënshkruarit

Z./Zj. []
në kapacitetin e tij si []

Kombësia: []
Mbajtës i Pasaportës ose ID Nr.: []
Lëshuar nga: []
Datë: []
Banues në: []

Cakton këtu Z./Zj. [] në kapacitetin e tij si [] që:

- të ekzekutojë dorazi ose të vulosur dhe të dorëzojë tek autoritetet kompetente të gjithë dokumentet e renditur në Programin 1 të bashkëngjitur;
- të dorëzojë dhe të marrë çdo dokument ose instrument në lidhje me dokumentet e renditura në Programin 1 këtu; dhe
- të bëjë të gjitha gjërat e nevojshme dhe të paparashikuara në lidhje me çështjet e përcaktuara këtu për të bërë, ekzekutuar dhe kryer çdo vepër ose akt tjetër që duhet të ekzekutohet ose përmbushet për të përfunduar ose ndryshe bërë efektive dokumentet e renditura në Programin 1.

Dhe këtu autorizohet të caktojë të tjerë për të gjitha ose pjesë të kompetencave të deleguara nga ky Autorizim për Përfaqësim.

Programi 1

DATE [Futni datën e ekzekutimit]

DELEGUESI [Fusni emrin e Ofertuesit të Mundshëm / Anëtarit të konsorciumit]

PËRFAQËSUESI LIGJOR [Fusni emrin e përfaqësuesit të Anëtarit Drejtues]

VENDI NË TË CILIN DOKUMENTET DO TË EKZEKUTOHEN DHE DORËZOHEN

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Sheshi "Skënderbe", Nr. 5 Tiranë, Shqipëri.

DOKUMENTET Të gjithë dokumentet në lidhje me Ofertën e deleguesit në lidhje me Koncesionin e Autostradës Milot - Morinë

ME ANË TË NËNSHKRIMIT Delegatesi ka ekzekutuar këtë Autorizim Përfaqësimi [me vulë] në datën e lartpërmendur.

[vula]

[emri dhe titulli i përfaqësuesit delegates]

[Vula dhe nënshkrimi i noterit]

Shtojca 8

Draft Kontratë Koncesioni

Dhënë veçmas.

Shtojca 9

Punimet Fillestare Gjeoteknike

Raportet Gjeoteknike të Tenderit japin një vlerësim të kushteve gjeoteknike dhe gjeologjike të Autostradës, si edhe rekomandime në lidhje me masat e nevojshme për stabilizimin e skarpateve dhe zvogëlimin e rrezikut gjeoteknik. Punimet Gjeoteknike fillestare duhet të realizohen në përputhje me vlerësimin dhe kërkesat që jepen në Raportet Gjeoteknike të Tenderit dhe duhen përcaktuar me hollësi në Planin Gjeoteknik Fillestar të Koncesionarit.

Raportet Gjeoteknike të Tenderit dhe Planet e lidhura me to¹ (tetor 2011, korrik & gusht 2015, dhe Mars 2016) përmbajnë një listë të pikave ku nevojiten masa për stabilizimin e skarpateve. Punimet Gjeoteknike Fillestare, sikurse përcaktohet në Planin Gjeoteknik Fillestar të Koncesionarit, do të përcaktojnë punimet në të gjitha pikat e identifikuar në Tabelën 1 më poshtë (masat më me përparësi). Skarpatet ku propozohen Punime Gjeoteknike me nivel përparësie 1 dhe 2, përshkruhen edhe në Raportet dhe Planet Gjeoteknike të Tenderit. Këto skarpate dhe punimet përkatëse do të përditësohen (duke përfshirë edhe çdo skarpate të identifikuar shtesë të autostradës që kërkojnë stabilizim) dhe përfshihen, sipas nevojës, në Planin për Menaxhimin e Punëve Gjeoteknike të Punimeve dhe Planeve Gjeoteknike të Mëpasshme (Klauzola 32A.2 e Kontratës së Koncesionit).

Numri i pikave ku ndodhen skarpatet e identifikuar në tabelën 1 është numri minimal i skarpateve që duhen përfshirë në planin e Punimeve Gjeoteknike Fillestare. Koncesionari duhet të bëjë vetë një vlerësim gjeoteknik të të gjitha skarpateve të autostradës, duke marrë në konsideratë gjendjen më të fundit gjeoteknike të tyre. Në varësi të rezultatit të këtij vlerësimi, Koncesionari mund të shtojë, në formën e një përditësimi të Planit Gjeoteknik Fillestar, skarpate të tjera të identifikuar si skarpate që kanë nevojë për ndërhyrje të ngutshme. Kostoja shtesë e realizimit të këtyre punimeve nuk rimbursohet nga Autoriteti Kontraktues. Punime të tilla përfundohen në përputhje me dispozitat e Klauzolës 32A.1 të Kontratës së Koncesionit për Punimet Gjeoteknike Fillestare.

Gjithashtu, Punimet Gjeoteknike Fillestare mund të devijojnë nga masat e propozuara në Raportet Gjeoteknike të Tenderit për cilëndo prej pikave të identifikuar në Tabelën 1. Në këto raste, masat alternative duhet të kenë një efekt pozitiv të paktën të njëjtë me masat e rekomanduara në Raportet Gjeoteknike të Tenderit dhe çdo ndryshim në çmim që vjen si pasojë duhet të përmendet në Preventivin me Çmime të parashikuar në Programin 7 të kësaj Kontrate. Në të gjitha rastet, masat gjeoteknike duhet të stabilizojnë skarpatet dhe të zvogëlojnë rrezikun afatgjatë. Inxhinieri i Pavarur jep pëlqimin e tij për secilin prej këtyre ndryshimeve në punime nëpërmjet aprovimit të Planit Gjeoteknik fillestar dhe çdo ndryshim të tij dhe verifikon që objekti dhe kostot e përgjithshme të punimeve të mbeten të njëjta në nivel material.

¹ a) Raporti Gjeologjik / Gjeoteknik për segmentet Milot – Rrëshen dhe Kukës – Morinë (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 10/2011).

b) Raporti Inxhinierik Gjeologjik / Gjeoteknik dhe Hartat Gjeologjike Inxhinierike dhe Plan-vendosjet e Renditjes së Rreziqeve, (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 10/2011).

c) Raporti Teknik i Fazës I (për vlerësimin e rreziqeve dhe masat për zvogëlimin/stabilizimin e rreziqeve) dhe Hartat gjeologjike inxhinierike të përditësuara dhe Plan-vendosjet e përditësuara të rreziqeve të vlerësuara, (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 07/2015).

d) Raport Teknik i Fazës II (për vlerësimin e përditësuar të rreziqeve dhe masat e përditësuara për zvogëlimin/stabilizimin e rreziqeve) (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 08/2015).

e) Raporti Teknik i fokusuar në përditësimin e Punimeve Fillestare Gjeoteknike Mars 2016 dhe Hartat gjeologjike inxhinierike të përditësuara dhe Plan-vendosjet e përditësuara të rreziqeve të vlerësuara, (Egnatia Odos S.A. – Planet S.A., 03/2016).

Plani Gjeoteknik Fillestar do të përgatitet, dhe ndryshohet sipas nevojës, në përputhje me Klauzolën 32A.1 të Kontratës së Koncesionit dhe jep minimalisht informacionet e mëposhtme në lidhje me Punimet Gjeoteknike Fillestare: lloji, shkalla, dimensionet, hollësitë teknike, specifikimet, skicat tip dhe/ose të hollësishme dhe llogaritjet dhe një pasqyrë në përputhje me grafikun kohor të përgjithshëm të Projektit.

Hartimi dhe çdo ndryshim i Planit gjeoteknik fillestar bëhet nga një ekip gjeoteknik i specializuar i përbërë, minimumi, nga një inxhinier gjeolog, një inxhinier gjeoteknik dhe një inxhinier i strukturave, ku secili duhet (i) të jetë i certifikuar ose i regjistruar nga një dhomë përkatëse e akredituar, ose në Shqipëri ose në Evropë ose nga një dhomë tjetër përkatëse që është e pranueshme për Inxhinierin e pavarur; (ii) të ketë të paktën 12 vjet përvojë në projekte të ngjashme me Projektin; dhe (iii) të ketë përvojë specifike në (a) në hartimin e hartave gjeologjike inxhinierike për projektet e infrastrukturës përfshirë projekte me natyrë të ngjashme me Projektin; dhe (b) projektimin e punimeve të stabilizimit të skarpatit, punimeve të dherave dhe themeleve për projektet e infrastrukturës përfshirë projekte me natyrë të ngjashme me Projektin.

Ekipi gjeoteknik do të vizitojë të gjitha skarpatet e autostradës dhe sidomos të gjitha pikat ku propozohet të merren masa për stabilizimin e skarpatit-zvogëlimin e rrezikut ose masa të tjera të propozuara nga Raportet Gjeoteknike të Tenderit dhe mbledh të gjitha informacionet e nevojshme për bërjen e një vlerësimi dhe rekomandimi të shëndoshë dhe të justifikuar.

Tabela 1: Përmbledhje e vendndodhjeve dhe llojeve të masave më përparësore të propozuara, Punimet Gjeoteknike Fillestare

Punimet Fillestare Gjeoteknike				
a\ a	Kilometrazh i Unifikuar (D: Djathtas, M: Majtas) (kilometri i rrugës siç është) -Kilometri i pjesëve të rrugës është i përafërt-	Kategori a e rrezikut, qershor 2015 dhe shkurt 2016	Prioriteti i supozuar	Masat e propozuara, qershor 2015 dhe shkurt 2016
